



HM Treasury

Përvoja britanike lidhur me shqyrtimin e bilancit: Kundërpërgjigjja buxhetore ndaj COVID19

qershor 2020

Vicky Rock, Graham Prentice, Costanza Tomaselli

Përse Britania bën shqyrtim të bilancit?



Pasqyra e bilancit gjithnjë e më shumë përdoret për ndërhyrjet e politikës mikroekonomike (kredi, dorëzani)

- Rritjet e riskut fiskal për qeverinë dhe madhësia e pasqyrës së bilancit për të marrë hua për investime



Fokus në rritje mbi pasqyrën e bilancit në menaxhimin e financave publike


- A po fuqizohet apo po dobësohet vlera neto?
- Mundësi për të menduar menaxhimin e aktiveve dhe pasiveve dhe për të fuqizuar qëndrueshmërinë buxhetore afatgjatë



Tani ka të dhëna të mira

- Llogaritë e Gjithë Qeverisjes (WGA) japin të dhëna të gjithanshme për aktivet dhe pasivet në mbarë sektorin publik dhe të dhëna më të qarta mbi pronësinë
- Përdorim në rritje i këtyre të dhënave nga organe të pavarura për të marrë në shqyrtim politikat e qeverisë

Konteksti: natyra e pasqyrës së bilancit të Britanisë ka ndryshuar ndjeshëm pas krizës financiare globale të vitit 2008/2009



Burimi: FMN me të dhëna nga Llogaritë e Gjithë Qeverisjes, të vihet re se Zyra Britanike për Statistikat Kombëtare publikon edhe të dhëna mbi pasqyrën e bilancit, pasqyrën e operacioneve dhe pasqyrën e flukseve të tjera ekonomike për sektorin publik në përputhje me Manualin për Statistikat Financiare të Qeverisjes 2014, shih në internet:

<https://www.ons.gov.uk/economy/governmentpublicsectorandtaxes/publicsectorfinance/datasets/internationalmonetaryfundsgovernmentfinancestatisticsframeworkinthepublicsectorfinancesappendix>

I kemi dhënë ekonomisë një mbështetje të paprecedentë e cila ka pasur ndikim në financat tona, por kostoja e mosveprimit do të kishte qenë më e lartë



Kundërpërgjigjja jonë ekonomike ndaj COVID-19

- Faza e parë e kundërpërgjigjes sonë ekonomike ka përfshirë marrjen nga ana jonë të hapave të paprecedentë për ta mbështetur ekonominë ta kalojë krizën; për të mbajtur sa më shumë njerëz në vendet ekzistuese të punës, për të mbështetur bizneset rentabël të vijojnë ekzistencën dhe për të mbrojtur të ardhurat e grupeve më të cenueshme.
- Këto masa synojnë mbrojtjen e kapacitetit produktiv të ekonomisë dhe për të mundësuar një rimëkëmbje të fortë e të qëndrueshme nga kjo krizë.



Ndikimi mbi financat tona

- Sipas çmuarjeve të Zyrës për Përgjegjësinë Buxhetore, kostoja e drejtpërdrejtë për qeverinë lidhur me kundërpërgjigjen nda koronavirusit do të jetë mbi 120 miliardë £ në 2020-2021.
- Krahas kësaj, është vënë në dispozicion një mbështetje e konsiderueshme në formë dorëzanish dhe kredish. Ekspozimi total i skemave të detyrimeve të kushtëzuar për COVID-19 është mbi 300 miliardë £1. Sipas Zyrës për Përgjegjësi Buxhetore humbjet për dorëzanitë për kreditë në vitin 2020/2021 janë 5 miliardë £2



Kundërpërgjigje me rimëkëmbjen si objektiv

- Mosmarrja e këtyre hapave do të bënte që pasojat e përkohshme të COVID-19 të linin shenja të përhershme në ekonominë tonë. Megjithëse jemi duke shpenzuar shuma të paprecedenta, ekziston konsensusi në qeveri dhe mes ekonomistëve të jashtëm se moskryerja e këtyre shpenzimeve në këto nivele do të shkaktonte dëm më të madh.



Po i kuptojmë gjithnjë e më mirë të dhënat dhe analizat si edhe kapacitetet institucionale

Mbledhja dhe publikimi i të dhënave mbi skemat

- Ekipet e politikave po bëjnë **raportim të rregullt mbi shpenzimet dhe arkëtimet** nëpërmjet bankës britanike për zhvillim për financimin e NVM-ve, bankës qendrore britanike, huadhënësve privatë etj.
- Edhe pse kjo ka qenë e vështirë në fillim për shkak të ritmit të krijimit të skemave, ekipet e politikave kanë arritur të krijojnë një qasje novatore në kohën e duhur për të përmbushur nevojat tona imediate për të dhëna, ndërsa tani **raportimi përpara Thesarit është zyrtarizuar dhe është duke u zbatuar.**
- Banka qendrore britanike, Thesari dhe ministritë e tjera publikojnë statistika mbi mbështetjen lidhur me koronavirusin për bizneset dhe individët në mënyrë të rregullt¹
- Zyra për Përgjegjësi Buxhetore publikon dhe përditëson rregullisht analizë për koronavirusin²

Kapaciteti dhe ekspertiza analitike dhe institucionale

- Organet e veçanta mund të kryejnë test të qëndrueshmërisë mbi detyrimet e tyre të kushtëzuara
- Jemi duke i rritur kapacitetet për të kryer vlerësim të riskut të portofolit dhe test të qëndrueshmërisë mbi portofolin britanik në bashkëpunim me aktuarë dhe ekspertë të riskut të kredisë.
- Jemi duke e rritur ekspertizën për të administruar dhe investuar në kapital.
- Në nivel qendror po fillojmë të përpilojmë:
 - Analizë të dhënash mbi mospagimin e kredive në nivel sektori dhe në nivel subjekti
 - Mbështetje teknike/këshillimore për analizën e riskut të kredisë

Në periudhën afatmesme deri afatgjatë nevojitet krijimi i mjedisit të duhur për të administruar një pasqyrë të zgjeruar bilanci

Si të sigurojmë se ndërhyrjet tona e maksimizojnë vlerën e parave të tatimpaguesve?

- Ndërhyrjet duhet të maksimizojnë vlerën e parave të tatimpaguesve në periudhën afatgjatë
- Për të siguruar maksimizim të vlerës së parasë mund të na duhet të vendosim kushte ose kufizime për marrjen e mbështetjes
- Ndërhyrjet që mbështetin rritjen ekonomike janë të mira për pasqyrën e bilancit

Cilat janë risqet e një pasqyre të zgjeruar bilanci?

- Ndërhyrjet e rritin borxhin
- Ndërhyrjet e rritin borxhin
- Kushtet e skemave mund të çojnë në klasifikimin e bizneseve në pasqyrën e bilancit të sektorit publik dhe në statistikat kombëtare

Si duhet ta zbutim këtë risk nëpërmjet politikës buxhetore?

- Kuadri buxhetor mund të reflektonte ndikimet në pasqyrën e zgjeruar të bilancit
- Risqet buxhetore në lidhje me këto kredi dhe bizneset të cilave u japim hua duhen mbajtur parasysh nga funksioni i riskut buxhetor të Thesarit

